

Të udhëtosh nuk është dhe aq e lehtë në kohët që po jetojmë. Ndryshimet e vogla në rutinën e përditshme mund të bëjnë diferencën. Kufizimet, sado të nevojshme, na shkëpusin e largojnë nga njëri-tjetri.

Duke qenë se sot ndodhem në zyrën tonë në Bruksel, e ndjeva të nevojshme të kujtoja rëndësinë e mbajtjes së lidhjes së fortë midis Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, dhe anasjelltas.

62 % e qytetarëve të rajonit tonë janë pro anëtarësimit në BE. Por ky nuk është një proces i lehtë. Situata po ndryshon, dhe po ndryshon shpejt. Globalisht, kombëtarisht, mes nesh, rajoni ynë po përpiqet të ecë përpara.

Ka mënyra të ndryshme për të përshpejtuar procesin e integritimit ekonomik të rajonit me BE-në. Por kemi një rrugëtim të vështirë dhe sfidues përpara drejt zhvillimit të qëndrueshëm të tranzicionit të gjelbër dhe dixhital.

Pra, për ta përmbledhur, ne po punojmë mbi tre pika:

Ulja e çmimeve të Roaming me BE.

Ju duket e drejtë apo normale që një qytetar nga Ballkani të paguajë 103 euro për giga, ndërsa kostoja e operatorit të telekomit është vetëm 8 euro?

Covid 19 ka ndikuar në shtimin e rasteve të njerëzve që vuajnë nga probleme të ndryshme mendore si frikë, ankth, depresion, trauma etj. Ne nuk jemi mjekë, por e kuptojmë se sa e rëndësishme është të ndihmojmë ata që ndihen të dobët. Duke filluar nga dhjetori, ata që janë më optimistët ndër ne, të rinjtë tanë nën drejtimin e RCC, do të punojnë me politikëbërësit për ndërgjegjësimin mbi shëndetin mendor.

Ky do të jetë prioriteti ynë.

Gjelbërimi i Ballkanit Perëndimor

Ne kemi ndjekur mbledhjen e organizuar për të diskutuar mbi çështjen e ndryshimeve klimatike në Glasgow.

Rajoni ynë e ka gati Axhendën e Gjelbër që ne duhet të zbatojmë. Por kjo nuk do të jetë e lehtë, apo pa kosto. BE-ja, sektori privat etj duhet të hapin instrumente financiare, që rajoni ynë të modernizojë infrastrukturën e tij dhe të përparojë në dekarbonizimin e vendeve tona.

Kemi ende punë për të bërë, le të punojmë të gjithë së bashku!